REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

4988

Maliq më 22 .09.2025

Projekt-Vendim _ NR. 5

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar , të nenit 8 pika 2 , nenit 9 nën pika 1.1, gërma "b",ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Në bazë të kërkesave të bëra nga familjet e mëposhtme dhe verifikimeve të bëra nga punonjesit socialë të Bashkisë Maliq për gjëndjen social-ekonomike për familjet e mëposhtme i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

I Miratim fondi për familjet e mëposhtëme:

Nr.	Emri Mbiemri	ID	Nj.Administrative	Shuma /Lekë
1	Aleko Hysaj	H20725033Q	Pojan	100000
2	Irma Agim Shkëmbi	I85129025V	Libonik	50000
3	Rajmonda Bramka	G45213238E	Maliq	40000
4	Roza Zere	H65505043A	Libonik	30000
5	Alketa Çorbaxhi	I95829106U	Pirg	30000
6	Sulejman Shake	E70408012R	Pojan	20000

I. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2025, si më poshtë :

	Gr	Kap	Kod.Prog.	Llog.eko	Emert.Logarise	Vlera në lekë
Pakësim	00	05	04980	609	Fondi rezervë	270000
Shtesë	00	05	01110	606	Fondi Social	270000

II. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacionin me gjëndjen Social–Ekonomike të familjes.

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi:Përgj.Sektorl Sherbimeve Sociale	J.Hoxha		Datë 22.09.2025.
Pranoi Drejtora e Shërbimit Social, Arsimit dhe Shëndetësisë	E.Petriti		Datë 22.09..2025
Pranoi:Drejtoria e Financës dhe Buxhetit	A.Muka		Datë 22.09.2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

4988

Maliq më 22.09.2025

Relacion

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve të mëposhtme rezultoi se:

1- **Roza Zere.**
Zonja Roza Zere jeton në fshatin Vloçisht ,Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq.Familja Zere perbehej nga katër anëtarë por në datë 23.04.2025 kryefamiljari Zoti Kujtim Zere ka ndëruar jetë në shtetin Greke pas një sëmundje të rëndë në zemër.Fëmijët e të ndjerit janë në moshë shkolle dhe kushtet ekonomike janë të rënduara. Familja ka pasur shpenzime të shumta si për kurimin e të ndjerit ashtu edhe për përballimin e shpenzimeve të varrimit.Bashkëshortja është e pa punë, ndodhur në këto kushte i është drejtuar Këshillit Bashhkiak për një ndihmë financiare për të përballuar shpenzimet.

2- **Irma Shkëmbi.**
Zonja Irma Shkëmbi jeton në fshatin Pocestë, Njësia Administrative Libonik,Bashkia Maliq. Familja Shkëmbi përbëhej nga 7 anëtarë por në datë 28.09.2024 familja u prek nga një fatkeqësi pasi bashkëshorti i zonjës Irma zoti Bledi Shkëmbi ka ndëruar jetë në shteti Amerikan. Mbas kësaj fatkeqësie familja Shkëmbi ndodhet në kushte të vështira ekonomike, i ndjeri la pas dy prindër të moshuar dhe dy fëmijë të vegjël të moshës 5 dhe 2 vjeç.Shpenzimet ekonomike të familjes janë të shumta dhe rritja e fëmijëve është e vështirë.Ndodhur në këto kushte zonja Irma i është drejtuar Këshillit Bashkiak për një ndihmë financiare për të përballuar shpenzimet.

3-Alketa Çorbaxhi
Zonja Alketa Çorbaxhi jeton në fshatin Sovjan, Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq.Alketa jeton e vetme me dy fëmijët e mitur pasi bashkëshorti ka ndërruar jetë pas një sëmundje të rrëndë. Të ardhurat e vetme të familjes vini nga bashkëshorti dhe të gjitha kursimet u shpenzuan pë kurimin e të ndjerit. Zonja Alketa e ka të pamundur përballimin e jetesës dhe ka vështirësi financiare për rritje e fëmijëve. Ndodhur në këto kushte zonja Alketa i drejtohet Këshillit Bashkiak për një ndihmë financiare për të përballuar shpenzimet.

4-Aleko Hysaj

Zoti Akelo Hysaj është banor i fshatit Zëmblak, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.Familja e zotit Aleko përbëhet nga dy anëtarë ai dhe bashkëshortja, Aleko trajtohet me Pak dhe ai ka kaluar disa operacione të vështira në këmbë të cilat kanë pasur kosto të larta. Ndodhur në këto kushte familja Hysaj ka shpenzuar të gjitha kursimet në operacionet e Akelos, gjendja ekonomike është e rënduar dhe a i duhet të kryejë operacionin e radhës. Aleko i drejtohet Këshillit Bashkiak për një ndihmë financiare për të përballuar shpenzimet e operacionit.

5-Sulejman Shake

Zoti Sulejman Shake është banor i fshatit Pojan, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.Familja e zotit Sulejman përbëhet nga tre anëtarë ai, bashkëshirtja dhe djali. Djali i zotit Sulejman trajtohet me Pak pasi ka probleme me këmbën dhe mer ilaçe të vazhdueshme bashkëshortja zonja Resmie Shake vuan nga një sëmundje e rëndë e syve dhe ka nevojë për operacion. Familja Shake jeton në kushte shumë të vështira ekonomike dhe të ardhurat e vetme janë pensioni i dy të moshuarve gjë e cila vështirëson jetesën dhe e bën të pamundur përballimin e shpenzimeve të operacionit të zonjës. Ndodhur në këto kushte zoti Sulejman i drejtohet Këshillit Bashkiak për një ndihmë financiare për të përballuar shpenzimet.

6-Rajmonda Bramka

Zonja Rajmonda Bramka është banore e fshatit Kolanec, Bashkia Maliq.Familja e Rajmondës përbëhet nga tre anëtarë, ajo bashkëshorti dhe djali, të tre anëtarët janë të papunë dhe Zonja Rajmonda vuan nga disa sëmundje kronike si ankthi, hipertensioni dhe kohët e fundit ka pasur probleme në Gjoksi dhe i duhet të bëjë disa vizita dhe terapi të cilat kushtojnë. Ndodhur në këto kushte zonja Rajmonda i drejtohet Këshillit Bashkiak për një ndihmë financiare për të përballuar kurimin.

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi:Përgj.Sektorl Sherbimeve Sociale	J.Hoxha		Datë 22.09.2025.
Pranoi Drejtora e Shërbimit Social, Arsimit dhe Shëndetësisë	E.Petriti		Datë 22.09..2025
Pranoi:Drejtoria e Financës dhe Buxhetit	A.Muka		Datë 22.09.2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ